



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010), nenin 4, paragrafi 3, nenin 76, paragrafi 6 dhe nenin 77, paragrafi 6 të Ligjit nr.05/L-045 për sigurimet (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.38/24 dhjetor 2015), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 28 prill 2016, miratoi si në vijim:

## **RREGULLORE PËR KONTROLLET E BRENDSHME DHE AUDITIMIN E BRENDSHËM TË SIGURUESVE**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i parimeve themelore mbi organizimin dhe operimin e kontrolleve të brendshme dhe funksionit të auditimit të brendshëm të siguruesve.
2. Kjo Rregullore aplikohet për të gjithë siguruesit dhe degët e siguruesve të jashtëm, të licencuar nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës të referuara në vijim si sigurues.

### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptim të njëjtë me termet e përkufizuara në nenin 3 të Ligjit nr. 05/L-045 për sigurimet ( më tutje Ligji për sigurimet), ose sipas përkufizimeve në vijim për qëllimin e kësaj Rregulloreje:
  - a) *Sistemi i kontrolleve të brendshme* është procesi i kontrolluar nga Bordi i drejtorëve, menaxherët e lartë dhe personeli tjetër i siguruesit, i themeluar për të ofruar siguri të arsyeshme, lidhur me arritjen e efikasitetit dhe efektivitet operacionale, raportimit të besueshëm financiar dhe respektimit të ligjeve, rregulloreve dhe politikave të zbatueshme.
  - b) *Funksioni i Auditimit të arendshëm* është aktivitet i pavarur, objektiv dhe këshillëdhënës i themeluar për të shtuar vlerën dhe përmirësimin e operacioneve të siguruesit. Ky funksion e ndihmon siguruesin në arritjen e qëllimeve të saj duke sjell një qasje sistematike të disiplinuar për vlerësimin dhe përmirësimin e efikasitetit të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe proceseve qeverisëse.
  - c) Për qëllime të kësaj Rregulloreje me termin “sigurues”, kuptohet “sigurues dhe/ose risigurues;

- d) *Rreziku i vetvetishëm* nënkupton rrezikun e pranishëm vazhdimisht, gjatë ushtrimit të aktivitetit të siguruesit, si rezultat i mungesës së funksionimit të sistemit të kontrolleve të brendshme.

### **Neni 3**

#### **Kërkesat për kontrollet e brendshme**

1. Siguruesit duhet të themelojnë një sistem të shëndoshë të kontrollit të brendshëm me qëllim të parandalimit të humbjeve, mirëmbajtjen e raportimit të besueshëm financiar dhe të menaxhmentit, zgjerimin e operimit të tyre të matur dhe promovimin e stabilitetit në sistemin financiar të Republikës së Kosovës.
2. Siguruesit, duhet të kenë një sistem efektiv të kontrolleve të brendshme që është në përputhje me natyrën, kompleksitetin dhe rrezikun e vetvetishëm në aktivitetet e zërave bilancor dhe jashtëbilancor dhe që kjo t'i përshtatet ndryshimeve të ambientit dhe kushteve të afarizmit të tyre.
3. Qëllimet e sistemit të kontrollit të brendshëm duhet të jenë zvogëlimi i mashtrimeve, shpërdorimeve dhe veprimeve të gabuara, si dhe të zvogëlojë rreziqet e tjera që përballen siguruesit, të cilat do të:
  - a) Nxitin efikasitetin dhe efektivitetin e aktiviteteve dhe masave të cilat i mbrojnë siguruesit në përdorimin e pasurive dhe resurseve të tjera dhe në mbrojtjen e tyre nga humbjet;
  - b) Sigurojnë besueshmëri, plotësi dhe përpikëri të informacioneve financiare dhe të menaxhmentit, ashtu që menaxherët e lartë, drejtorët, aksionarët, palët e jashtme dhe mbikëqyrësit të mund të mbështeten në to për vendimmarrje, dhe
  - c) Sigurojnë pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret dhe politikat e zbatueshme.
4. Një sistem efektiv i kontrollit të brendshëm përbëhet nga komponentët e ndërlidhur në vijim:
  - a) mbikëqyrja nga bordi i drejtorëve, menaxherët e lartë dhe kultura e kontrollit;
  - b) njohja dhe vlerësimi i rrezikut;
  - c) kontrolli i aktiviteteve dhe ndarja e detyrave;
  - d) informimi dhe komunikimi; dhe
  - e) monitorimi i aktiviteteve dhe korrigjimi i mangësive.

### **Neni 4**

#### **Mbikëqyrja nga bordi i drejtorëve, menaxherët e lartë dhe kultura e kontrollit**

1. Bordi i drejtorëve dhe menaxherët e lartë janë përgjegjës për promovimin e standardeve të larta të etikës dhe integritetit dhe për vendosjen e kulturës brenda siguruesit, e cila thekson dhe demonstroi rëndësinë e kontrolleve të brendshme për të gjitha nivelet e personelit. Menaxherët e lartë sigurojnë që i gjithë personeli të kuptojë rolin e tyre në procesin e kontrollit të brendshëm dhe se do të jenë plotësisht të përfshirë në këtë proces.
2. Bordi i drejtorëve është përgjegjës për drejtimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e siguruesit dhe për të siguruar që punët janë duke u kryer në interesin më të mirë të tij. Bordi i drejtorëve ka për detyrë të veprojë me kujdes në përmbushjen e detyrës së rëndësishme të udhëheqjes dhe mbikëqyrjes së

aktiviteteve të menaxhereve të lartë, duke siguruar që operacionet ditore të siguruesit janë në duar të personave të kualifikuar, të ndershëm dhe kompetent.

3. Detyrat specifike të bordit të drejtorëve në fushën e kontrollit të brendshëm janë:
  - a) aprovimi dhe rishikimi, së paku në baza vjetore i strategjisë gjithëpërfshirëse të biznesit dhe politikave të rëndësishme të siguruesit;
  - b) themelimi i strukturës organizative, përfshirë njësitë e tij operative, nën-njësitë, funksionet dhe pozitat mbikëqyrëse të siguruesit;
  - c) themelimi i komitetit të auditimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 30 të Ligjit për sigurimet;
  - d) identifikimi i rreziqeve kryesore me të cilët ndeshet siguruesi, të vendosë nivele të pranueshme për këto rreziqe dhe të sigurojë që menaxhmenti i lartë është duke mbikëqyrur efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm;
  - e) rishikimi formal, së paku njëherë në vit, i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe funksionit të auditimit të brendshëm;
  - f) të sigurojë themelimin dhe funksionimin efektiv të sistemit të kontrollit të brendshëm.
4. Menaxherët e lartë janë përgjegjës për kontrollet organizative dhe procedurale të siguruesit, duke siguruar integritetin e kontrolleve të brendshme dhe duke vendosur një ekip efektiv të menaxhmentit, i cili karakterizohet me kulturë profesionale të kontrollit dhe që është përgjegjës për përmbushjen e përgjegjësisë së tij;
5. Detyrat specifike të menaxherëve të lartë në fushën e kontrollit të brendshëm janë:
  - a) implementimi i strategjisë dhe politikave të aprovuara nga bordi i drejtorëve;
  - b) zhvillimi i proceseve të cilat identifikojnë, matin, mbikëqyrin dhe kontrollojnë rreziqet e shkaktuara nga siguruesi;
  - c) mirëmbajtja e strukturës organizative, e cila në mënyrë të qartë përcakton përgjegjësitë, autoritetin dhe marrëdhëniet e raportimit;
  - d) të sigurojë që përgjegjësitë e deleguara të përmbushen në mënyrë efektive, të vendosë politika të duhura të kontrollit të brendshëm dhe të monitorojë përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm;
  - e) të sigurojë që shërbimet e kontraktuara të çfarëdo lloji, të jenë me kontraktues të cilat kanë një sistem të përshtatshëm të kontrollit të brendshëm. Kontratat për këto shërbime duhet të përcaktojnë se auditorët e jashtëm, auditorët e brendshëm dhe ekzaminerët e BQK-së do të kenë qasje në çfarëdo lloji dokumentacioni, burim informacioni ose sistemi që mund të kërkohet në kryerjen e funksioneve të tyre përkatëse.

## **Neni 5**

### **Njohja dhe vlerësimi i rrezikut**

1. Të gjitha rreziqet materiale të cilat mund të kenë ndikim të pafavorshëm në arritjen e synimeve të siguruesit duhet të njihen dhe të vlerësohen vazhdimisht. Ky vlerësim duhet të mbulojë të gjitha rreziqet me të cilat përballlet siguruesi dhe grupi i konsoliduar, pjesë e të cilit është siguruesi, (përfshirë rrezikun e marrjes në sigurim, duke parashikuar dhe vlerësuar rrezikun maksimal të

mundshëm, rrezikun e rezervave, rrezikun e likuiditetit, rrezikun operacional dhe rrezikun e reputacionit.

2. Kontrollat e brendshme duhet të rishikohen së paku një herë në çdo vit, për të adresuar në mënyrë të duhur ndonjë rrezik të ri dhe të pakontrolluar më parë.
3. Vlerësimi efektiv i rrezikut duhet të identifikojë dhe të marrë parasysh faktorët e brendshëm (siç janë: kompleksiteti i strukturës organizative, natyra e aktiviteteve të siguruesit, cilësia e personelit, ndryshimet organizative dhe lëvizjet e stafit) si dhe faktorët e jashtëm (siç janë: ndryshimi i kushteve ekonomike, ndryshimet në industri dhe avancimet teknologjike), të cilat mund të cenojnë arritjen e synimeve të siguruesit.
4. Vlerësimi i rrezikut duhet të kryhet në të gjitha nivelet e aktiviteteve individuale dhe përmes spektrit të gjerë të aktiviteteve. Ky vlerësim duhet të adresojë aspektet e matshme dhe jo të matshme të rrezikut dhe duhet të peshojë kostot e kontroleve përkundrejt benefiteve që ato sigurojnë.
5. Procesi i vlerësimit të rrezikut duhet gjithashtu të përfshijë edhe vlerësimin e rreziqeve për të përcaktuar se cilat nga ato janë të kontrollueshme dhe cilat janë të pakontrollueshme nga siguruesi. Për rreziqet që janë të kontrollueshme, siguruesi duhet të vlerësojë nëse duhet t'i pranojë ato ose masën deri në të cilën dëshiron të zvogëlojë rreziqet përmes procedurave kontrolluese. Për rreziqet e pakontrollueshme, siguruesi duhet të vendosë nëse duhet të pranojë këto rreziqe ose të tërhiqet nga to, apo të zvogëlojë nivelin e aktiviteteve afariste të lidhura me këto rreziqe.

## **Neni 6**

### **Kontrolli i aktiviteteve dhe ndarja e detyrave**

1. Aktivitetet e kontrollit duhet të jenë pjesë përbërëse e aktiviteteve ditore të siguruesit. Menaxhmenti i lartë duhet të mirëmbajë strukturë të përshtatshme të kontrollit, me aktivitetet e kontrollit të definuara në çdo nivel të biznesit, duke përfshirë: rishikimet e nivelit të lartë, aktivitete të përshtatshme të kontrollit për departamente dhe njësi të ndryshme, kontrole fizike, kontrolli për pajtueshmëri me limitet e ekspozuara dhe përcjellja e mospajtueshmërisë, sistem të aprovimeve dhe autorizimeve, sistem të verifikimeve si dhe bashkërenditjeve.
2. Aktiviteti i kontrollit duhet të disenjohet dhe të implementohet për të adresuar rreziqet e identifikuar nga siguruesit, përmes procesit për vlerësimin e rrezikut. Aktivitetet e kontrollit ndahen në dy faza:
  - a) themelimin e politikave dhe procedurave adekuate të kontrollit; dhe
  - b) verifikimin se këto politikat dhe procedurat janë duke u zbatuar;
3. Aktivitetet e kontrollit duhet të përfshijnë të gjitha nivelet e personelit të siguruesit, prej menaxhmentit të lartë deri te personeli i linjës së parë.

4. Detyrat duhet të shpërndahen në mënyrë të duhur dhe personelit nuk do t'i caktohen përgjegjësitë që mund të rezultojnë me konflikt të interesit. Fushat e konflikteve të mundshme të interesit duhet të identifikohen, minimizohen dhe të jenë subjekt i monitorimit të kujdesshëm dhe të pavarur.

## **Neni 7**

### **Informimi dhe komunikimi**

1. Menaxhmenti duhet të mbledhë, regjistrojë dhe mbajë të dhëna të brendshme adekuate dhe gjithëpërfshirëse financiare, operative dhe të pajtueshmërisë, si dhe informacione të jashtme të tregut lidhur me ngjarjet dhe kushtet të cilat janë relevante për vendimmarrje. Informacionet duhet të jenë të besueshme, në kohë dhe të arritshme, si dhe të mbajtura në një format të qëndrueshëm.
2. Sistemet e besueshme të informacioneve duhet të vendosen për të mbuluar të gjitha aktivitetet e rëndësishme të siguruesit. Këto sisteme, përfshirë ato të cilat përmbajnë dhe përdorin të dhëna në formë elektronike, duhet të jenë të siguruar, të mbikëqyrur në mënyrë të pavarur dhe të mbështetur nga plane adekuate në raste emergjente.
3. Menaxhmenti duhet të mbajë linja efektive të komunikimeve për të siguruar që stafi kupton në tërësi dhe mbështet politikat dhe procedurat të cilat ndikojnë në detyrat dhe përgjegjësitë e tyre dhe se informacionet e tjera relevante i komunikohen personelit të duhur.

## **Neni 8**

### **Monitorimi i aktiviteteve dhe korrigjimi i mangësive**

1. Efektiviteti i përgjithshëm i kontrolleve të brendshme të siguruesit duhet të monitorohet në vazhdimësi nga bordi i drejtorëve dhe menaxherët e lartë. Monitorimi i rreziqeve kryesore duhet të jetë pjesë e aktiviteteve ditore i të gjitha fushave operacionale dhe afariste të siguruesit. Në procesverbalet e mbledhjeve të bordit të drejtorëve duhet të përfshihen veprimet e ndërmarra lidhur me mangësitë e identifikuar nga kontrolli i brendshëm.
2. Politikat dhe procedurat e brendshme të siguruesit, duhet të vendosin linja të qarta të përgjegjësisë për çdo fushë operacionale dhe afariste. Rishikimet periodike dhe të ndara duhet të kryhen nga fushat operacionale dhe afariste dhe të raportohen mangësitë e kontrollit të brendshëm në baza të caktuara kohore tek niveli i duhur i menaxhmentit dhe të adresohen me përpikëri. Mangësitë materiale në kontrollin e brendshëm duhet të raportohen tek menaxherët e lartë, komiteti i auditimit dhe bordi i drejtorëve.
3. Sistemi i kontrollit të brendshëm të siguruesit, duhet të plotësohet me funksion efektiv të auditimit të brendshëm, i cili në mënyrë të pavarur vlerëson sistemin e kontrollit të siguruesit. Një auditim i brendshëm gjithëpërfshirës dhe efektiv i sistemit të kontrollit të brendshëm duhet të kryhet nga stafi i pavarur, kompetent dhe i trajnuar në mënyrë të duhur.

## **Neni 9**

### **Funksioni i Auditimit të Brendshëm**

1. Funkzioni i auditimit të brendshëm është pjesë e monitorimit të vazhdueshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm të siguresit, i cili siguron një vlerësim të pavarur të adekuatshmërisë dhe pajtueshmërisë me politikat dhe procedurat e vendosura të siguresit. Si i tillë, funksioni i auditimit të brendshëm ndihmon menaxherët e lartë dhe bordin e drejtorëve në kryerjen efikase dhe efektive të përgjegjësisë të tyre.
2. Fushëveprimi i funksionit të auditimit të brendshëm duhet të përfshijë:
  - a) ekzaminimin dhe vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm;
  - b) rishikimin e aplikimit dhe efektivitetin e procedurave për menaxhimin e rrezikut dhe metodologjive për vlerësimin e rrezikut;
  - c) rishikimin e sistemeve të menaxhmentit dhe të informacioneve financiare, përfshirë sistemin elektronik të informacioneve të siguresit;
  - d) rishikimin e saktësisë dhe besueshmërisë së regjistrave të kontabilitetit dhe të raporteve financiare;
  - e) rishikimin e sistemit të siguresit për vlerësimin e kapitalit në lidhje me vlerësimin e rrezikut;
  - f) vlerësimin e ekonomicitetit dhe efikasitetit të operacioneve;
  - g) testimin e transaksioneve dhe të funksionimit të procedurave specifike të kontrollit të brendshëm;
  - h) rishikimin e sistemeve të themeluara për të siguruar pajtueshmëri me kërkesat ligjore dhe rregullative, kodin e sjelljes dhe implementimin e politikave dhe procedurave;
  - i) testimin e besueshmërisë dhe përpikshmërisë së raportimeve rregullative dhe
  - j) kryerjen e detyrave specifike të auditimit.
3. Menaxhmenti i lartë është përgjegjës të sigurojë që njësia e auditimit të brendshëm të mbahet plotësisht e informuar lidhur me zhvillimet e reja, iniciativat, produktet dhe ndryshimet operacionale.
4. Secili sigures duhet të ketë funksionin e auditimit të brendshëm në mënyrë që të përmbushë detyrat dhe përgjegjësitë e tij. Bordi i drejtorëve duhet të jetë përgjegjës që të sigurojë pavarësinë e funksionit të auditimit dhe që burimet e mjaftueshme materiale dhe njerëzore të jenë të disponueshme për kryerjen adekuate të funksioneve dhe detyrave të tij.
5. Funkzioni i auditimit të brendshëm duhet të jetë i pavarur nga aktivitetet e audituara dhe nga proceset ditore të kontrollit të brendshëm. Udhëheqësi i njësisë së auditimit të brendshëm duhet të ketë autoritetin të komunikojë drejtpërdrejt dhe me iniciativën e tij/saj me auditorin e jashtëm, me bordin e drejtorëve ose përmes komitetit të auditimit. Bordi i drejtorëve vendos për kompensimin e udhëheqësit të njësisë së auditimit të brendshëm.
6. Vendimi mbi dorëheqjen ose largimin e udhëheqësit të njësisë së auditimit të brendshëm si dhe arsytet e dorëheqjes ose largimit, duhet t'i komunikohen BQK-së brenda shtatë ditëve të punës.

7. Secili sigurues duhet të ketë një statut të shkruar të auditimit që shpreh qëndrimin dhe autoritetin e funksionit të auditimit të brendshëm brenda siguruesit. Statuti i auditimit të brendshëm duhet të përcaktojë së paku:
  - a) objektivat dhe fushëveprimin e funksionit të auditimit të brendshëm;
  - b) pozitën e njësisë së auditimit të brendshëm brenda siguruesit, fuqitë e tij, përgjegjësitë dhe marrëdhëniet me funksionet e tjera kontrolluese; dhe
  - c) përgjegjësinë e udhëheqësit të njësisë së auditimit të brendshëm.
8. Statuti i auditimit duhet të jetë i hartuar dhe të rishikohet periodikisht nga njësi e auditimit të brendshëm; duhet të aprovohet nga komiteti i auditimit dhe më pas të konfirmohet nga bordi i drejtorëve, si pjesë e rolit të tij mbikëqyrës;
9. Statuti i auditimit duhet t'i japë mandat njësisë së auditimit të brendshëm me të drejtën për të iniciuar kontroll dhe të autorizojë atë që të ketë qasje dhe të komunikojë me çdo anëtar të personelit të siguruesit, të ekzaminojë çdo aktivitet ose njësi të siguruesit, si dhe të ketë qasje në çdo regjistër, dosje ose të dhëna, përfshirë informacionet e menaxhmentit dhe procesverbalet e të gjitha trupave konsultativë dhe vendimmarrës, kurdo që është e rëndësishme për kryerjen e detyrave të tij;
10. Statuti duhet të përcaktojë afatet dhe kushtet në të cilat njësi e auditimit të brendshëm mund të thirret për të ofruar shërbime konsultative ose këshilluese ose të përmbushë detyra të tjera specifike.
11. Përveç statutit të sipër cekur të auditimit, bordi duhet të sigurojë edhe statutin e komitetit të auditimit, që rregullon organizimin dhe funksionimin e këtij komiteti.
12. Kompetenca profesionale e çdo auditori të brendshëm dhe e funksionit të auditimit të brendshëm është thelbësore për funksionimin adekuat të auditimit të brendshëm.  
Anëtarët e njësisë së auditimit të brendshëm duhet të përmbushin kërkesat siç janë përshkruar në vazhdim:
  - i. aftësi profesionale që nevojiten për të implementuar dhe përcjell standardet procedurale dhe teknikat e auditimit në fushat operuese të siguruesit;
  - ii. njohuri dhe përvojë lidhur me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar;
  - iii. njohuri të parimeve për administrimin e rreziqeve dhe teknikave prudenciale të auditimit të brendshëm të institucioneve financiare.Udhëheqës i njësisë së auditimit të brendshëm do të zgjidhet një individ me reputacion të lartë etik dhe profesional dhe me përvojë adekuate në fushën sigurimeve dhe të auditimit.
13. Udhëheqësi i njësisë së auditimit të brendshëm duhet të përgatit një plan të auditimit për caktimin dhe kryerjen e detyrave, i cili do të aprovohet nga bordi i drejtorëve. Ky aprovim nënkupton që siguruesi do të ofrojë burimet e nevojshme për njësinë e auditimit të brendshëm.
  - a) plani vjetor i auditimit duhet të përfshijë në detaje kohëzgjatjen dhe frekuencën e auditimit të brendshëm, burimeve të nevojshme për sa i përket personelit dhe duhet të bazohet në një vlerësim të shkruar të rreziqeve materiale të kontroleve të brendshme, të azhurnuara për çdo vit;

- b) Raportet e njësisë së auditimit të brendshëm duhet t'i prezantohen komitetit të auditimit dhe bordit të drejtorëve, të cilat përmbajnë gjetjet dhe rekomandimet si dhe përgjigjet e menaxherëve të lartë;
  - c) Raportet dhe letrat e punës duhet të mbahen së paku pesë vite;
  - d) Njësia e auditimit të brendshëm duhet të përcjellë rekomandimet e tij për të verifikuar nëse ato janë zbatuar.
14. Udhëheqësi i njësisë së auditimit të brendshëm duhet të përgatitë dhe dorëzojë një raport vjetor për performancën në lidhje me punën e bërë për kontrollin e brendshëm, si vijon:
- a) raporti vjetor i udhëheqësit të njësisë së auditimit të brendshëm duhet t'i prezantohen komitetit të auditimit dhe bordit të drejtorëve, ku do të përfshihen gjetjet dhe rekomandimet si dhe përgjigjet e menaxherëve të lartë.
  - b) procesverbalet e takimeve të komitetit të auditimit dhe bordit të drejtorëve duhet të përfshijë një kopje si dhe dëftesën e pranimit të raportit të tillë dhe veprimet e ndërmarra në lidhje me të metat e identifikuara nga auditimi i brendshëm.

#### **Neni 10**

#### **Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile**

Shkelja e dispozitave të kësaj Rregulloreje, do të jetë subjekt i masave administrative dhe dënimeve me gjobë siç përcaktohet në Ligjin nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore dhe Ligjin 05/L-045 për sigurimet.

#### **Neni 11**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 2 maj 2016. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregulla 26 e BQK-së mbi kontrollin e brendshëm e aprovuar më 28 mars 2002 dhe çdo dispozitë tjetër që mund të jetë në kundërshtim me këtë Rregullore.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

---

Prof. Dr. Bedri Peci